



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.369/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjor Florije Krasniqi - Pireva, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lavdim Gaxherri, në cilësinë e Administratorit të Qendrës së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në Junik, paraqitur ankesë kundër Demokrat Ganijaj, anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor në Komunën e Junikut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur me 12.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET** e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, Anr.369/2021 e datës 11.02.2021, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, për inkurajimin kërcënimin apo mbështetjen e dhunës ose kanosjes në mbajtjen e fushatës zgjedhore ndaj kandidatëve të subjektit politik LVV, me qëllim të përfutimit elektoral, në fushatë zgjedhore, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më datë 14.02.2021, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2,000.00 (dy mijë) euro, për të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënimin e shqiptimit të dënimit shtesë.

**II. I NDALOHET** Demokrat Ganijaj, Anëtar i KKZ-së nga radhët e subjektit politik LDK, në Komunën e Junikut, pjesëmarrja në zgjedhje, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhore për periudhën kohore, në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, nga dita e marrjes së vendimit, duke përfshirë edhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më datë 14.02.2021.

## A r s y e t i m

Parashtuesi i ankesës në cilësinë e Administratorit të Qendrës së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, në Junik, ka paraqitur ankesë në PZAP, më datë 11.02.2021 kundër anëtarit të Komisionit Komunal Zgjedhor në Komunën e Junikut, Demokrat Ganijaj, me të cilën pretendon se më datë 07.02.2021, gjatë homazheve të Kandidatit për kryeministër nga ana e subjektit politik LVV-së, Albin Kurti, në shenjë hakmarrje ndaj tij ka bërë aktin e protestës me prapavijë politike duke i dhuruar dy vezë.

Më tej parashtruesi i ankesës shton se Demokrat Ganiqaj, anëtar i KKZ-së në Junik ka bërë një postim në rrjetin social facebook me shkrimin ‘Baca Isë u kry, mora hak, jo me dhunë por me modesti’. Ky postim nga ana e zyrtarit të KKZ-së shfaqë hakmarrje të qartë politike dhe se me këtë ka degraduar pozitën zyrtare duke shkelur dispozitat ligjore përkatëse.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur dy fotografi të printuara si provë ndaj shkeljes si dhe një CD.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli, pas shikimit të bërë në CD-të si dhe fotografive të postuara në faqen e tij të rrjetit social facebook, nga përmbajtja e të njëjtës pa mëdyshje vërtetohet se Anëtari i KKZ-së, Demokrat Ganiqaj, ka penguar bërjen e fushatës ndaj subjektit politik LVV, respektivisht kandidatin për kryeministër, Albin Kurti si dhe pengimin e fushatës e ka publikuara duke postuar fotografinë e kryetarit të subjektit politik të LDK-së, Isa Mustafa duke cituar “Bac Isë u kry – mora hak jo me dhunë por me modesti” duke shfaqur anshmëri në përkrahjen e subjektit të caktuar politik.

Paneli, për të vendosur dhe pranuar një ankesë si të bazuar vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 33 pika d) ku përcaktohet se gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ndalohet çrregullimi i tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitja e të tjerëve për një veprim të tillë.

Paneli me rastin e vendosjes si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, është vendosur duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet d) Ndalohet një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite”. Për më tepër neni 34 i LZP-ës, ka përcaktuar se, ndalohet inkurajimi, mbështetja ose miratimi i dhunës ose kërcënimeve me dhunë apo kanosje gjatë procesit zgjedhor, e që sipas të dhënave të KQZ-ës – vendimi 104-2021 i datës 15.01.2021 se bashku me listën përbërëse, zyrtari i KKZ-ës Demokrat Ganiqaj rezulton se është pjesë e subjektit politik të LDK-ës, si anëtar i KKZ-ës në komunën e Junikut.*

Paneli në mënyrë të pa dyshimit ka vërtetuar se anëtari i KKZ, Demokrat Ganiqaj në cilësinë e kryerësit të supozuar në këtë rast, e ka penguar mbajtjen e tubimit politik në fjalë gjatë fushatës zgjedhore dhe po ashtu veprime kanosëse siç vet ka konstatuar “mora hak” e që e ka publikuar në rrjetet sociale, e për më tepër veprimet e tilla rezultojnë se janë në kundërshtim edhe me kodin e sjelljes për anëtarë të KKZ-së, pasuesi 2 dhe germa i) i Rregullores Nr.18/2016.

Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se anëtari KKZ-së në Komunën e Junikut, ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura sepse ka vepruar në mënyrë jo profesionale madje edhe duke penguar mbarëvajtjen e tubimit zgjedhor të subjektit politik LVV.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenin 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par.3 pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 369/2021 më datën 12.02.2021

**Kryesuesi i Panelit**

Burim Ademi



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.